



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:236289

Datë: 13.08.2024

Numri i dokumentit: 06045493

CAP.nr.1618/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtarja individuale Frosina Sylejmani, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit I... Sh.P.K me seli në Prishtinë, kundër debitorit Radio Televizioni i Kosovës – RTK3 me seli në Prishtinë, me objekt të përmbarimit kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1476/18, të datës 03.04.2019, me datë 13.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit në Prishtinë shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike.

II. Lënda i dërgohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale në Prishtinë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr.1476/18, të datës 03.04.2019, ka refuzuar të pabazuar prapësimin e debitorit Radio Televizioni i Kosovës RTK me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.992/18 të datës 25.10.2018 i organit përmbarues – përmbaruesit privat Kushtrim Metaj.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë debitori, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit, të anulohet aktvendimi PPP.nr.1476/18, të datës 03.04.2019dhe urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.992/18 i datës 25.10.2018 të lejuar nga përmbaruesi privat.

Kreditori nuk na parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të tjera të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 29, 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se, në nenin 13 par.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, është përcaktuar: “Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: pika 1.1 “kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë

*dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”, ndërsa paragrafi 6 i nenit 13 i të njëjtit ligj përcakton: “Dhomat e shkallës së dytë janë kompetente për të trajtuar: pika 6.1, “ të gjitha ankesat ndaj vendimeve të dhomave të shkallës së parë brenda kompetencave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni”, andaj referuar këtyre dispozitave ligjore dhe duke qenë se palët ndërgjyqëse në këtë procedurë janë persona juridik, për vendosje në këtë çështje juridike përmbartimore, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë.*

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në bazë të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 29 dhe 208 të LPK-së, e lidhur me nenin 13 par.1 pika 1.1 dhe par.6 pika 6.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale nr.08/L-015.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.1618/2023, datë 13.08.2024

Gjyqtarja  
Frosina Sylejmani